



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

V E N D I M

NR. 11/9 DATË 02 / 12 / 2021

PËR

**MIRATIMIN E STATUSIT “INVESTIM/INVESTITOR STRATEGJIK
PROCEDURË E VEÇANTË” PËR PROJEKTIN E INVESTIMIT
“MEDITERRANEAN WAVE” ME SUBJEKT APLIKUES SHOQËRIA
“MEDITERRANEAN WAVE” SH.P.K. ME NUIS M11916014A**

Në mbështetje të Nenit 9, 17, 18, 21, 22, 24, 27 dhe 29 të Ligjit Nr. 55/2015 “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Kreut II, pika 8 e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike”, Komiteti i Investimeve Strategjike, me propozim të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA),

VLERËSOI:

- Subjekti aplikues, shoqëria "Mediterranean Wave" sh.p.k. me NUIS M11916014A, propozon zhvillimin e një investimi strategjik në Zonën Kadastrale Nr. 2909, fshati Peqinaj, Bashkia Kavajë, me vlerë investimi 50,409,836 (pesëdhjetë milion e katërqind e nëntë mijë e tetëqind e tridhjetë e gjashtë) Euro, realizimi i të cilit parashikon të hapë 80 vende të reja pune.
- Projekti i investimit synon ndërtimin e një kompleksi turistik, i cili do të jetë multidimensional në tipologjitë e akomodimit dhe faciliteteve që do t'u ofrojë pushuesve dhe vizitorëve. Kompleksi do të ketë në përbërje hotele, vila hotelerie (fshat turistik), shërbime të hotelerisë, parqe dhe hapësira për aktivitete dhe sistemime të vijës bregdetare. Struktura akomoduese do të ketë rreth 250 njësi (përfshi vila hotelerie, studio, apartament hotel), 170 dhoma dhe suita hoteli dhe më shumë se 700 vende parkimi, 150 shtëpi me tarracë dhe 5 parqe të gjelbëruara. Projektimi i këtij

investimi të propozuar është realizuar nga një studio ndërkombëtare e mirënjohur dhe zhvillimi i këtij projekti parashikon standarde të larta të aplikuara.

- Sipërfaqja e ndërtimit është 130,350 m² dhe mbi 69,318 m² sipërfaqe ndërtimi të hapura, me një total prej 199,668 m² sipërfaqe ndërtimore.
- Vlera e investimit të projektit “Mediterranean Wave” me subjekt aplikues shoqëria "Mediterranean Wave" sh.p.k. me NUIS M11916014A i plotëson kriteret e parashikuara nga legjislacioni për investimet strategjike dhe parashikohet të jetë 50,409,836 (pesëdhjetë milion e katërqind e nëntë mijë e tetëqind e tridhjetë e gjashtë) Euro.
- Projekti i investimit i plotëson kriteret e punësimit të kërkuara nga legjislacioni për investimet strategjike. Përgjatë realizimit të investimit dhe operimit, numri i personave të punësuar parashikohet të jetë 80 (tetëdhjetë) persona.
- Masat kryesore mbështetëse që kërkon subjekti aplikues për realizimin e këtij projekti investimi në zbatim të nenit 27 dhe nenit 29 të Ligjit Nr. 55/2015, i ndryshuar, janë dhënia e së drejtës së përdorimit dhe shfrytëzimit të një sipërfaqeje prej 635,000 m², "Pyll", në pronësi të shtetit shqiptar, sipas Aneks 1 bashkëlidhur dhe e drejta e përdorimit të brigjeve të detit si dhe zonës përkatëse të plazhit në funksion të realizimit të këtij projekti, sipas Aneks 2 bashkëlidhur.

Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka konfirmuar se, nga verifikimi i koordinatave rezulton se ato shtrihen në zonë bregdetare dhe janë pjesë e stacioneve bregdetare. Koordinatat i korrespondojnë (i) parcelës KJ-236, e cila mund të jepet për menaxhim dhe për të cilën nuk ka aplikim; (ii) parcelës KJ-237, për të cilën është nënshkruar kontratë me një subjekt tregtar, me afat 5 vjeçar, me datë mbarimi datën 15.11.2025 dhe sipërfaqe 2000 m²; dhe (iii) parcelës KJ-238, e cila është parcelë publike.

Agjencia Shtetërore e Kadastrës ka konfirmuar se sipërfaqe e kërkuar për verifikim kadastral pozicionohet vetëm në pasurinë nr. 106/22, volum 4, faqe 70, ZK. 2909, me sipërfaqe 806,013 m², e llojit “Pyll”, në pronësi të Republika e Shqipërisë, në Përgjegjësi Administrimi të Ministrisë Përgjegjëse të Turizmit, sipas VKM Nr. 707, datë 21.11.2018.

Në përfundim, pasi u njoh me gjithë dokumentacionin e nevojshëm,

KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDOSI:

1. Miratimin e Statusit “Investim/Investitor strategjik procedurë e veçantë” për projektin e investimit “Mediterranean Wave”.
2. Projekti “Mediterranean Wave” do të realizohet nga subjekti "Mediterranean Wave” sh.p.k. me NUIS M11916014A.
3. Projekti strategjik parashikon realizimin e investimit në sektorin strategjik të turizmit.
4. Projekti do të zhvillohet në Zonën Kadastrale Nr. 2909, fshati Peqinaj, Bashkia Kavajë.
5. Në sipërfaqen totale të kërkuar prej 635,000 m², sipërfaqja totale e ndërtimit është rreth 199,668 m².
6. Statusi “Investim/Investitor strategjik procedurë e veçantë” i jepet projektit të investimit “Mediterranean Wave”, për një periudhë 4 (katër) vjeçare, përveç afatit të lejimit të përdorimit të brigjeve të detit dhe të zonës përkatëse së plazhit si dhe afateve të lejimit të përdorimit të pasurive të paluajtshme shtetërore, të cilat vendosen me Vendim të Këshillit të Ministrave, sipas legjislacionit të investimeve strategjike.
7. Në përputhje me legjislacionin për investimet strategjike, përkatësisht nenet 21, 22, 24, 27 dhe 29 të Ligjit Nr. 55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, masat mbështetëse që i jepen projektit janë si më poshtë:
 - a) Miratohet masa mbështetëse e kryerjes së procedurave me prioritet dhe brenda afateve të përshpejtuara, në përputhje me legjislacionin për investimet strategjike;
 - b) Miratohet masa mbështetëse e asistencës në lidhje me dhënien e lejeve, licencave dhe autorizimeve të nevojshme për realizimin e projektit, në përputhje me afatet e parashikuara sipas legjislacionit të investimeve strategjike;
 - c) Miratohet në parim masa mbështetëse dhënia e së drejtës së përdorimit dhe shfrytëzimit të sipërfaqes së llojit 'Pyll', me pronësi Republika e Shqipërisë, me sipërfaqe 635,000 m², e cila, sipas të dhënave të kartelës së pasurisë në ASHK Kavajë ndodhet e pozicionuar në hartat me nomenklaturë K-34-99-(159-A,B,C,D) dhe mban nr. pasurie 106/22, volum 4, faqe 70, Zona Kadastrale 2909, Peqinaj Kavajë, pasi kjo sipërfaqe të jetë hequr nga

sipërfaqja pyjore publike, sipas legjislacionit specifik sektorial për pyjet.

Duke qenë se brenda zonës ku do të zhvillohet projekti strategjik, në ZK.2909, në pasurinë nr.106/22, Bashkia Kavajë, ndodhet monumenti natyror “Foleza e Bardhorit”, shpallur me VKM Nr. 303, datë 10.05.2019 “Për miratimin e listës së rishikuar, të përditësuar, të monumenteve të natyrës shqiptare”, në të cilën zbatohet shkalla më e lartë e mbrojtjes, duhet që, gjatë zhvillimit të projektit, të ruhet gjendja natyrore e këtij monumenti, referuar nenit 17, të Ligjit nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”. Për këtë qëllim, investitori të respektojë dhe të zbatojë me korrektësi kushtet e lejes mjedisore, përgjatë vijës ndarëse me kufirin e monumentit. Kufiri i MN “Foleza e Bardhorit” dhe koordinatat gjenden në Aneks 3 bashkëlidhur këtij vendimi. Investitorit nuk i lejohet asnjë lloj veprimtarie brenda këtij monumenti.

Në zbatim të nenit 27 të Ligj Nr. 55/2015, i ndryshuar, miratimi përfundimtar i masës mbështetëse të mësipërme, do të rregullohet me Vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me legjislacionin në fuqi të turizmit mbi zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, lidhur me mënyrën dhe afatet e vënies në dispozicion të këtyre pasurive të paluajtshme në pronësi të shtetit shqiptar, me qëllim realizimin e strukturave akomoduese turistike të parashikuar në këtë projekt investimi, pasi të bëhet ndryshimi i destinacionit të llojit 'Pyll' dhe pasi të bëhen verifikimet e nevojshme të pronës nga ASHK, sipas koordinatave të dhëna nga investitori dhe për aq kohë sa nuk ekzistojnë mosmarrëveshje administrative dhe/ose gjyqësore me shtetin në pasurinë objekt të investimit strategjik.

- ç) Në zbatim të nenit 29 të Ligjit Nr.55/2015, i ndryshuar, miratohet në parim masa mbështetëse e lejimit të përdorimit të brigjeve të detit si dhe zonës përkatëse të plazhit përballë kompleksit, por në asnjë rast për një afat më të gjatë se 30 (tridhjetë) vjet, me përjashtim të parcelës KJ-237, për të cilën është nënshkruar kontratë me një subjekt tregtar, me afat 5 vjeçar, me datë mbarimi datën 15.11.2025 dhe sipërfaqe 2000 m². Kjo parcelë do t'i vihet në dispozicion subjektit strategjik pas përfundimit të kontratës në fjalë.

Miratimi përfundimtar, planvendosja e vijës bregdetare sipas stacioneve të miratuara të plazhit dhe tarifa e përdorimit të brigjeve të detit dhe të zonës përkatëse së plazhit në

funkcion të realizimit të projektit investues strategjik do të përcaktohen nëpërmjet një Vendimi të Këshillit të Ministrave, pasi të jenë konfirmuar këto koordinata nga institucionet e përfshira në vlerësim.

8. Mënyrat, procedurat, afatet dhe organet zbatuese për ofrimin e masave mbështetëse përcaktohen edhe në planin e veprimit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
9. Në rast se përgjatë zhvillimit dhe zbatimit të projektit investues strategjik "Mediterranean Wave" konstatohen të dhëna të pavërteta, të rreme apo ndryshime të të dhënave të dala rishtazi, mbi bazën e të cilave nuk do të ishte vendosur për miratimin e statusit strategjik të këtij projekti me procedurën e veçantë, Komiteti i Investimeve Strategjike ka të drejtë të revokojë vendimin për dhënien e statusit strategjik.
10. Ngarkohet Bashkia Kavajë për rishikimin e Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV), për përshtatjen e njësive strukturore sipas treguesve të rinj të miratuar referuar projektit të investimit strategjik në fjalë.
11. Ngarkohet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për të propozuar në Këshillin e Ministrave vendimin për heqjen e pasurisë së paluajtshme shtetërore, sipas Aneks 1 të këtij vendimi, nga sipërfaqja pyjore publike, sipas legjislacionit specifik sektorial për pyjet dhe vënien e saj në dispozicion për realizimin e projektit të investimit strategjik "Mediterranean Wave", në zbatim të legjislacionit në fuqi për zonat me përparësi zhvillimin e turizmit.
12. Ngarkohet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, pasi të bëjë verifikimin e koordinatave të brigjeve të detit si dhe të zonës përkatëse të plazhit, sipas Aneks 2 të këtij vendimi, të propozojë në Këshillin e Ministrave Vendimin "Për lejimin e përdorimit të brigjeve të detit në funksion të realizimit të projektit investues strategjik "Mediterranean Wave"".
13. Ngarkohet Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për monitorimin e Planit të Veprimit, të miratuar me këtë vendim.
14. Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike, në asnjë rast nuk do të konsiderohet investim, qoftë sipas kuadrit vendas ashtu edhe atij ndërkombëtar, në fuqi në Republikën e Shqipërisë, duke qenë se miraton në parim realizimin e një projekti investimi, materializimi i të cilit do të bazohet në përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve që parashikojnë legjislacionet sektoriale në fuqi.
15. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i njoftohet investitorit.

KRYETARI I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

PLANI I VEPRIMIT

PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT STRATEGJIK “MEDITERRANEAN WAVE”

1. Përmbajtja e planit të veprimit

Plani i veprimit për realizimin e një projekti strategjik, përcakton:

- Procedurat lehtësuese që do të zbatohen për realizimin e investimit strategjik dhe afatet e përshpejtuara brenda të cilave duhet të kryhen;
- Shërbimet ndihmëse që do të ofrohen ndaj projektit strategjik;
- Masat mbështetëse që do të nevojiten për mbështetjen e investimit strategjik;
- Organet përgjegjëse për zbatimin e investimit strategjik;
- Detyrat përkatëse për secilin organ të përfshirë në realizimin e investimit strategjik;
- Programin e punës për realizimin e investimit strategjik të detajuar në faza;

2. Zbatimi i planit të veprimit

Plani i veprimit monitorohet nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, e cila koordinon veprimtarinë me organet e tjera shtetërore dhe me investitorin.

Autoritetet publike, të përfshira në mënyrë direkte apo indirekte në realizimin e një investimi strategjik, kanë detyrimin ligjor në lidhje me trajtimin me prioritet të procedurave dhe brenda afateve të përshpejtuara. Këto organe kanë detyrimin ligjor që të bashkëpunojnë dhe t'i japin Agjencisë, sqarime, informacione, lejet, licencat, autorizimet, mendimet dhe dokumentet e nevojshme në lidhje me përgatitjen, zbatimin dhe realizimin e tij.

3. Informacione të përgjithshme mbi Planin e Veprimit të projektit “Mediterranean Wave”

Ky plan veprimi për realizimin e Projektit të Investimit “Mediterranean Wave” përcakton masat, procedurat dhe afatet, në lidhje me shërbimet dhe lehtësimin e procedurave për hartimin dhe zbatimin e projektit investues strategjik, në të cilin përcaktohen angazhime, detyra dhe afate konkrete për institucionet qendrore dhe njësitë e qeverisjes vendore, për të gjitha fazat e realizimit dhe zbatimit të projektit.

Plani i veprimit, u hartua nga grupi operacional i krijuar pranë Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, bazuar në karakteristikat e projektit të propozuar. Për këtë qëllim,

propozuesi i investimit strategjik, ka listuar dhe treguar qartësisht në momentin e paraqitjes së aplikimit, procedurat, shërbimet, dhe masat mbështetëse konkrete, të cilat kërkon të përfitojë nga shteti shqiptar, për realizimin e investimit.

Plani i veprimit u hartua pasi propozimi i paraqitur mbi investimin strategjik të Projektit “**Mediterranean Wave**” është vlerësuar paraprakisht dhe ka një rekomandim pozitiv të Komitetit të Investimeve Strategjike në lidhje me miratimin e tij. Autoriteti përgjegjës për miratimin e planit të veprimit për çdo projekt strategjik të miratuar është Komiteti i Investimeve Strategjike.

4. Hapat procedurale

Propozimi nga investitorët:

Investitori "Mediterranean Wave" sh.p.k. me NUIS M11916014A kur paraqiti projektin e investimit strategjik tek AIDA, në përputhje me legjislacionin ka specifikuar edhe listën e procedurave, shërbimeve dhe masat mbështetëse që kërkon për realizimin e investimit strategjik.

Masat mbështetëse që kanë një vlerësim pozitiv nga KIS janë si më poshtë vijon:

Masat e kërkuara	Rekomandimi	Institucioni përgjegjës	Procedura për masën e kërkuar e detajuar në faza. Detyrimet sipas institucioneve përgjegjëse	Dokumentacioni i nevojshëm që duhet të paraqesë subjekti	Afati	Kosto
Dhënia e së drejtës së përdorimit dhe shfrytëzimit të sipërfaqes së llojit “Pyll” në pronësi Republika e Shqipërisë, me sipërfaqe 635, 000 m ² , e cila sipas të dhënave të kartelës së pasurisë në ASHK Kavajë ndodhet e pozicionuar në hartat me nomenklaturë K-34-99- (159-A,B,C,D) dhe mban Nr.106/22 pasurie, volum 4 faqe 70 Zona Kadastrale 2909, Peqinaj Kavajë.	PO Të bëhet ndarja e pronës në ASHK sipas koordinatave referuese të dhëna nga investitori; të ndryshohet destinacioni; të vihet në dispozicion sipas legjislacionit të turizmit.	MTM Bashkia Kavajë				

Dhënia e së drejtës së përdorimit dhe shfrytëzimit të sipërfaqes ranore të plazhit në funksion të ofrimit të një shërbimi sa më gjithëpërfshirës dhe cilësor të kompleksit turistik.	PO	MTM AKB Bashkia Kavajë			
Ndërtimi i një infrastrukture rrugore në përputhje me standardet e infrastrukturës së kompleksit për të mundësuar lidhjen e kompleksit me Superstradën Durrës - Kavajë. Kjo rrugë është gjurmë ekzistuese por jo në standardin e duhur për mirëfunksionimin e kompleksit turistik në projekt për t'u ndërtuar. Gjatësia e rrugës është afërsisht 10.2 km dhe pas daljes nga Superstrada Durrës - Kavajë, përshkon fshatrat Synej, Bago, Peqinaj, Bardhor deri në destinacion.	PO	Bashkia Kavajë Kompetencë e Njësive të Qeverisjes Vendore.	Rrugët lidhëse të projektit (segmenti rrugor Synej, Bago, Peqinaj, Bardhor deri në destinacion) nuk janë në inventarin e ARRSH, por të Njësive të Qeverisjes Vendore. Kompetencë e Njësive të Qeverisjes Vendore. ARRSH jep vetëm autorizimet për hyrje-daljet, dhe lidhjet me rrugët kombëtare, nëse ka të tilla, në përputhje me dispozitat e Kodit Rrugor dhe akteve të tjera ligjore. Pa autorizimin e entit pronar të rrugës nuk mund të përcaktohen hyrje dhe degëzime të reja të rrugës për te objektet anësore dhe as lidhje të reja me rrugë të përdorimit publik a privat.		
Ndërtimi i një rrjeti dhe impianti për trajtimin e ujërave të zeza (KUZ + impiant trajtimi) që do t'i shërbejë kompleksit dhe zonës përreth për të siguruar ruajtjen e parametrave të nevojshëm mjedisor për zhvillimin e zonës dhe turizmit bregdetar në zonë.	PO	Bashkia Kavajë	Domosdoshmëri për funksionimin e projektit por dhe impakt për zonat e banuara që përshkon ky rrjet inxhinerik nëntokësor.		

<p>Ndërtimi i një rrjeti të ri për furnizimin me ujë të pijshëm të kompleksit dhe të gjithë zonës. Aktualisht rrjeti i furnizimit me ujë është funksional, por shumë i amortizuar për shkak të vjetërsisë dhe diametrit të vogël të linjave të furnizimit.</p>	<p>PO</p>	<p>Bashkia Kavajë</p>	<p>Domosdoshmëri për funksionimin e projektit por dhe impakt për zonat e banuara që përshkon ky rrjet inxhinerik nëntokësor.</p>			
<p>Ndërtimi i një rrjeti të ri të furnizimit me energji elektrike. Rrjeti aktual është mjaft i amortizuar dhe i pamjaftueshëm për përballimin e kapaciteteve të shtuara dhe kërkesave të shtuara për energji elektrike.</p>	<p>PO ME KUSHT</p>	<p>MIE</p>	<p>MIE: Po me kusht Ligjin Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” nenit 27 të tij “Lidhja me rrjetin”, Operatorët e Sistemit të Transmetimit dhe Shpërndarjes duhet të sigurojnë lidhjen me rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes mbi kushte jodiskriminuuese. ERE, në bashkëpunim me operatorët e rrjeteve, miraton rregullat që përcaktojnë kostot që do t'i ngarkohen përdoruesit në lidhje me kushtet e veçanta të pikës së lidhjes. Operatorët e Sistemit të Transmetimit dhe Shpërndarjes i japin çdo përdoruesi të ri që dëshiron të lidhet me rrjetin informacion të plotë, përfshirë: a) një vlerësim të plotë dhe të hollësishëm të kostove për realizimin e lidhjes së kërkuar; b) afatin e nevojshëm e të arsyeshëm për përpunimin e kërkesës dhe të realizimit të lidhjes me rrjetin. Përdoruesit e rinj që dëshirojnë të lidhen</p>			

			<p>në rrjet, pas miratimit të kërkesës për lidhjen e tyre nga ana e operatorit përkatës të sistemit, mund të kontraktojnë operatorë të licencuar nga organet kompetente për kryerjen e punimeve të nevojshme për lidhjen në rrjet, në përputhje me dispozitat dhe specifikimet e përcaktuara në marrëveshjen e lidhjes, të nënshkruar ndërmjet përdoruesit të ri dhe operatorit të sistemit. Operatori i sistemit përcakton kriteret dhe kushtet teknike që duhet të plotësohen për lidhjen me rrjetin. Për sa i përket kostove për lidhjen me rrjetin, kostot e plota për lidhjen me rrjetin ekzistues mbulohen nga pala që kërkon të lidhet në rrjet. Në llogaritjen e kostos së lidhjes merren në konsideratë pika e lidhjes dhe kapaciteti i saj; qëllimi i synuar; modeli i konsumit; kostot që lidhen me përforcimin ose përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese ose përmirësimin e operimit të rrjetit që mund të nevojitet për lidhjen; statusi i përdoruesit të rrjetit; si dhe karakteristika të tjera të lidhjes. Kur lidhja realizohet prej operatorit të</p>			
--	--	--	---	--	--	--

			<p>sistemit, kostot e lidhjes parapaguhen nga pala kërkuese, bazuar në rregulloren për procedurat e lidhjeve të reja.</p> <p>Operatori i Sistemit të Transmetimit ose Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, në rast mungese të kapaciteteve të nevojshme për lidhjen e përdoruesve të rinj, mund të hyjë në marrëveshje me palën kërkuese për përmirësimin e sistemit, në mënyrë që të bëhet e mundur lidhja e kërkuar, me kusht që kostot të përballohen nga pala kërkuese. Kjo marrëveshje duhet të miratohet nga ERE, pas propozimit nga operatorët e rrjetit.</p> <p>Në rast të lidhjes së përdoruesve të rinj të rrjetit, pronësia e aseteve të lidhjes që i shtohen rrjetit ekzistues është e përdoruesit, deri në amortizim të plotë të aseteve apo në përfundim të autorizimit të dhënë, bazuar në marrëveshjen e lidhjes, nënshkruar ndërmjet palëve.</p> <p>Pas amortizimit të plotë të aseteve të lidhjes, pronësia e tyre kalon tek operatori i rrjetit. Lidhjet operohen prej operatorëve të rrjetit, të cilët kanë përgjegjësi për mirëmbajtjen e tyre. Kostoja për mirëmbajtjet paguhet prej</p>			
--	--	--	---	--	--	--

			<p>përdoruesit. Neni 29 Aksesi i palëve të treta</p> <p>1. Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes garantojnë aksesin në rrjet për të gjithë klientët dhe përdoruesit e sistemit, mbi baza transparente, jodiskriminuese dhe bazuar në tarifatat e miratuara dhe të publikuara nga ERE. Prodhuesit, që prodhojnë energji nga burime të rinovueshme, kanë përparësi në aksesin në rrjetet elektrike.</p> <p>2. Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes mund të refuzojnë aksesin në rrjetin e tyre, në rast se mungon kapaciteti i nevojshëm. Vendimi për refuzimin e aksesit në rrjet duhet të jetë i arsyetuar, të bazohet në kushte teknike dhe ekonomike objektive dhe duhet të marrë në konsideratë detyrimin e shërbimit publik si dhe detyrimet për mbrojtjen e klientëve fundorë, të përcaktuara nga ky ligj. Vendimi për refuzimin e aksesit i njoftohet palës së interesuar.</p> <p>3. Në rast se një pale të interesuar i është refuzuar aksesin në rrjet, ajo mund të kërkojë</p>			
--	--	--	--	--	--	--

			fillimin e procedurës për zgjidhje të mosmarrëveshjes pranë ERE-s. 4. Në rast refuzimi të aksesit, ERE, nëpërmjet operatorit të rrjetit, i siguron palës së interesuar informacionin shtesë të nevojshëm.			
--	--	--	--	--	--	--

KRYETARI I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

KRYEMINISTRI

EDI RAMA